



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 479/2022

Vlerësimi i qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës

Prishtinë, 26 dhjetor 2023

QËLLIMI I RAPORTIT

1. Raporti ka për qëllim të vlerësojë gjendjen në komunat e Republikës së Kosovës lidhur me qasjen fizike për personat me aftësi të kufizuara në objektet dhe në hapësirat publike, sipas kritereve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara. Raporti tërheq vëmendjen e komunave të Republikës së Kosovës për ndërmarrjen e veprimeve konkrete duke siguruar qasje të papenguar të lëvizjes, të qëndrimit dhe të punës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe kushte të përshtatshme për qasje në objekte dhe në hapësira publike.

I. KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Ndërsa paragrafi 3 i nenit 132 përcakton: *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*
3. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënpar. 1.2);*
 - *“të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, par. 1, nënpar. 5);*
 - *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, par. 1, nënpar. 6);*
 - *“të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);*
 - *“të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 8);*
 - *“t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv (neni 18, par. 1, nënpar. 9).”*

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t’i kryejë përgjegjësitë sipas dispozitave ligjore të lartcekura.

II. RRETHANAT E RASTIT

4. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka iniciuar hetime sipas detyrës zyrtare, në lidhje me vlerësimin e kushteve dhe të qasjes për persona me aftësi të kufizuara në objekte dhe në hapësira publike nëpër komunat e Republikës së Kosovës, në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara (më tej: *udhëzimi*).
5. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka përpiluar një pyetësor me 41 pyetje, të formuluar sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim.
6. Me qëllim të vlerësim të qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit ua dërgoi pyetësorin 38 komunave të Republikës së Kosovës, si në vijim:
 - Më 21 korrik 2023, pyetësori u është dërguar Komunës së Prishtinës, Komunës së Kamenicës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Leposaviqit, Komunës së Gjakovës, Komunës së Gjilanit, Komunës së Drenasit, Komunës së Deçanit, Komunës së Kaçanikut, Komunës së Klinës, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Obiliqit, Komunës së Ferizajt, Komunës së Istogut dhe Komunës së Dragashit.
 - Më 24 korrik 2023, pyetësori u është dërguar komunës së Malishevës, komunës së Podujevës, komunës së Prizrenit, komunës së Shtimes, komunës së Pejës, komunës së Hanit të Elezit, komunës së Rahovecit, komunës së Junikut dhe komunës së Mitrovicës së Jugut.
 - Më 25 korrik 2023, pyetësori u është dërguar Komunës së Skenderajt, Komunës së Suharekës, Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Mamushës dhe Komunës së Vitisë.
 - Më 26 korrik 2023, pyetësori u është dërguar Komunës së Mitrovicës së Veriut, Komunës së Kllokotit dhe Komunës së Graçanicës.
 - Më 31 korrik 2023, pyetësori u është dërguar Komunës së Parteshit, Komunës së Shtërpçës, Komunës së Zubin Potokut, Komunës së Zveçanit, Komunës së Ranillugut dhe Komunës së Novobërdës.
7. Më 14 gusht 2023, Avokati i Popullit pranoi përgjigjet në pyetësorin, nga Komuna e Deçanit; më 15 gusht 2023 nga Komuna e Ranillugut dhe e Novobërdës; më 18 gusht 2023 nga Komuna e Prishtinës; më 22 gusht 2023 nga Komuna e Kaçanikut dhe e Klinës; më 24 gusht 2023 nga Komuna e Fushë Kosovës, e Obiliqit, e Ferizajt, e Istog; më 25 gusht 2023 nga Komuna e Pejës, e Hanit të Elezit, e Mamushës dhe e Vitisë; më 28 gusht 2023 nga Komuna e Dragashit, e Rahovecit, e Junikut dhe e Kllokotit; më 29 gusht 2023 nga Komuna e Mitrovicës Jugore; më 30 gusht 2023 nga Komuna e Graçanicës dhe më 5 shtator 2023 nga Komuna e Prishtinës (*një pjesë tjetër e informatave*); më 23 tetor 2023 nga Komuna e Drenasit.
8. Komuna e Prishtinës i ka dërguar Avokatit të Popullit dy shkresa përkitazi me pyetësorin, një më 18 gusht dhe tjetrën më 5 shtator 2023. Në shkresën e 18 gushtit 2023, Komuna e Prishtinës, përkatësisht Zyra Ligjore, ka njoftuar se pas shqyrtimit të kërkesës, ka vlerësuar se pyetësori u është dorëzuar gabimisht, prandaj të njëjtin e ka përcjellë tek organi kompetent - Drejtoria për Urbanizëm. Më 5 shtator 2023, Avokati i Popullit pranoi shkresën e dytë nga Komuna e Prishtinës, përkatësisht nga Drejtoria e Urbanizmit, sipas

së cilës, të dhënat në pyetësor janë plotësuar sipas kompetencës së kësaj drejtorie, ndërsa pyetjet e tjera - thuhet në përgjigje - janë kompetencë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit e Komunës së Prishtinës.

9. Avokati i Popullit, shkresën për plotësimin e pyetësorit përkitazi me këtë rast, ia kishte dërguar kryetarit të komunës së Prishtinës, më datën 21 korrik 2023, njëjtë sikurse shkresat e njëjta me pyetësor që ua kishte dërguar 37 kryetarëve të komunave të tjera. Me gjithë çështjen që drejtoritë e Komunës së Prishtinës e kanë ngritur lidhur me kompetencën për t'u përgjigjur në pyetësor, e që në fakt paraqet çështje të brendshme të Komunës, kjo komunë është përgjigjur vetëm në tri pyetjet me përgjigje "Po", ndërsa në të gjitha pyetjet e tjera janë përgjigjur me "N/A".
10. Nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, të cilave u është dërguar pyetësori, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga 21 komuna. Të dhënat e dërguara nga 21 komunat janë paraqitur në formë tabelore, më poshtë në këtë raport. Komuna e Prishtinës, edhe pse është përgjigjur vetëm në disa pyetje, ajo në asnjërën prej tyre nuk është përgjigjur me "Jo", prandaj kësaj komune nuk do t'i dërgohen rekomandime.

IV. SFONDI LIGJOR

11. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), neni 3, paragrafi 2, Barazia para Ligjit, përcakton: "*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*"
12. Neni 24, Barazia para Ligjit, përcakton:
 1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
 2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë [...], aftësisë së kufizuar [...]*
 3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*
13. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 3 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], përcakton:

"Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj."
14. Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 25 [Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit], përcakton:
 1. *Të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.*
 2. *Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi*

kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.

3. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.”

15. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj (më tej: Konventa) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejt sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 22, paragrafi 2) dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Neni 14 i Konventës përcakton: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo statusi tjetër.”*
16. Ndërsa sipas nenit 1, paragrafi 2, të Protokollit Nr. 12, parashihet: *“Askush nuk mund të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsytet e parashikuara në paragrafin 1.”*
17. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), neni 1, paragrafi 1, përcakton: *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimi në bazë [...], aftësisë së kufizuar [...].”*
18. LMD-ja, në nenin 1, paragrafi 1, përcakton qëllimin e këtij ligji: *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtetësisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”*
19. LMD-ja, mes të tjerash, në nenin 4 [Llojet e trajtimit të pabarabartë], paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, përcakton: *“Mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveçse kur është një barrë e paarsyeshme për personin që është i detyruar ta ofrojë dhe kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë në konsideratë për këtë qëllim faktorë të tillë si përdorimi i burimeve të disponueshme publike, pjesëmarrjen në jetën sociale dhe publike dhe garantimin e qasjes në vendin e punës dhe kushte të përshtatshme pune.”*
20. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 4, paragrafi 2, përcakton: *“Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.”*

21. Neni 17 [Kompetencat vetanake] përcakton: “Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
 - i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
 - p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
 - s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.”
22. Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim, neni 1 [Qëllimi], përcakton: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kornizës ligjore e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës.”
23. Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar, përkatësisht nenin 7 [Elementet Obligative për Qasje], pika 1, përcakton: “1) Elementet obligative për qasje janë: A. elementet për qasjen në nivele me lartësi të ndryshme; B. elementet e qasjes për jetë të pavarur; C. elementet për qasje në komunikacion publik.”

III. ANALIZA DHE KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

24. Sipas nenit 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej: GjEDNj).
25. GjEDNj-ja në praktikën e saj ka një numër të rastesh me të cilat trajton qasjen në ndërtesat publike dhe në ndërtesat e hapura për publikun. Në shumë prej këtyre rasteve GjEDNj-ja, për arsye të ndryshme, nuk kishte gjetur shkelje. Në rastin *Arnar Helgi Laruson kundër Islandës*, gjykata kishte konstatuar se kërkuesi nuk ishte diskriminuar, sepse autoritetet kishin ndërmarrë masat adekuate për të adresuar qasjen në ndërtesat publike, brenda kufijve të buxhetin në dispozicion dhe duke pasur parasysh mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të ndërtesave për të cilat kërkuesi ka pretenduar se nuk janë të qasshme për të. Çfarë është veçanërisht me rëndësi të theksohet në këtë rast edhe në raste të tjera të ngjashme, është se GjEDNj-ja në veçanti i referohet Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësitë e Kufizuara, e cila përcakton se mohimi i qasjes në objekte dhe në shërbime të hapura për publikun e personave me aftësi të kufizuara duhet të shihen si diskriminim.
26. Në rastin *Enver Sahin kundër Turqisë*, ka të bëjë me një person paraplegjik, të cilit i pamundësohej qasja fizike në një ndërtesë të universitetit me qëllim të kryerjes së studimeve akademike. Gjykata kishte vendosur shkelje të nenit 2, E drejta për arsim, Protokollit nr. 1, në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë rast gjykata kishte deklaruar se shteti turk nuk duhej të mbetej thjesht pasiv, nuk mund ta neglizhonte vendosjen e çështjes lidhur me qasshmërinë e hyrjes në ambientet e universitetit për ankuesin dhe kërkonte masa pozitive nga shteti.

27. Edhe tek rasti *Sahin kundër Turqisë*, dhe të shumë raste tjera ku trajtohet qasja në objekte dhe në hapësira publike e personave me aftësi të kufizuar dhe ku është konstatuar se ka pasur diskriminim, GjEDNj-ja i referohet Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësitë e Kufizuara.
28. Çfarë Avokati i Popullit dëshiron të vërë në pah është fakti se GjEDNj-ja e trajton mungesën e qasjes në objekte dhe në hapësira publike si diskriminim, në rastet kur vërtetohet ekzistenca e një lidhjeje të veçantë ndërmjet mungesës së qasjes në objektet publike me nevoja të veçanta që ndërlidhen me të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
29. GjEDNj-ja e përjashton diskriminimin në rastet kur vërtetohet se autoritetet kanë ndërmarrë masa adekuate për ta adresuar qasjen në ndërtesat publike dhe kur për lehtësimin e qasjes për individët me aftësitë e kufizuara, shtetet përballen me një barrë joproporcionale. Te rasti *Glaisen kundër Zvicres*, GjEDNj-ja e shpalli kërkesën të papranueshme, ngase mendonte se neni 8 (E drejta e respektimit të jetës private) i Konventës nuk mund të interpretohet lidhur me kërkimin e qasjes në një kinema të caktuar për të parë një film, kur qasja në kinema të tjera në afërsi ishte e mundur.
30. Pa marrë parasysh nenin 14 të Konventës dhe praktikën e sipërpërmendur të GjEDNj-së, kriteret për të krijuar qasje për personat me aftësi të kufizuar janë përcaktuar me ligj, përkatësisht me udhëzimin. Udhëzimi në nenin 1 të tij përcakton: “*Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohen kushtet teknike dhe mënyra e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuar (në tekstin e mëtejme PAK) dhe modernizimi i qasjes në objektet ndërtimore publike për destinim pune, banimi dhe banesor-afariste, si dhe kushtet dhe mënyra e përshtatshmërisë së thjeshtë të qasjes në objektin ndërtimor me destinim banimi dhe banesor-afarist.*”
31. Neni 1 i Protokollit 12 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit], në paragrafin 1 parashikon: “*Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.*” Ndërsa në paragrafin 2 parashikon: “*Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsytet e parashikuara në paragrafin 1.*”
32. Rasti më i mirë për ta sqaruar fushëveprimin e nenit 1 të Protokollit 12 të KEDNj-së është rasti *Sejdić dhe Finci k. Bosnjës dhe Hercegovinës*:
- “*Gjykata vëren se ndërsa neni 14 i Konventës ndalon diskriminimin në gëzimin e “të drejtave dhe lirive të përcaktuara në [Konventë]”, neni 1 i Protokollit nr. 12 e zgjeron fushën e mbrojtjes në “çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”. Në këtë mënyrë prezanton një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit.*
- Kërkuesit kundërshtuan dispozitat kushtetuese që i bënë ata të papërshtatshëm për t'u zgjedhur në Presidencën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Prandaj, nëse zgjedhjet për Presidencën bien apo jo brenda fushëveprimit të nenit 3 të Protokollit nr. 1, kjo ankesë ka të bëjë me një “të drejtë të përcaktuar me ligj” (shih seksionet 1.4 dhe 4.19 të Aktit Zgjedhor 2001 - shih paragrafin 18 më lart) që e bën të zbatueshëm Nenin 1 të Protokollit Nr. 12.[...].”*

33. Madje, sipas Raportit Shpjegues të Protokollit nr. 12, fushëveprimi i mbrojtjes së atij neni ka të bëjë me katër kategori rastesh, në veçanti kur një person diskriminohet:
- “Në gëzimin e çdo të drejte që i jepet në mënyrë specifike një individ sipas ligjit kombëtar;
 - në gëzimin e një të drejte që mund të nxirret nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas ligjit kombëtar, domethënë, kur një autoritet publik është i detyruar sipas ligjit kombëtar të sillet në një mënyrë të caktuar;
 - nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional (për shembull, dhënien e subvencioneve ose ndihmave);
 - nga çdo veprim ose mosveprim tjetër nga një autoritet publik (për shembull, sjellja e oficerëve të zbatimit të ligjit kur kontrollojnë një revoltë).” (§ 22 i Raportit shpjegues).
34. Kategoritë e sipërpërmendura zbatohen edhe në rastin *Savez Crkava “Riječ Života” & al. k. Kroacisë (pikat 104 dhe 105)*.
35. Rrjedhimisht, nisur nga interpretimi i nenit 1 të Protokollit 12, i cili shtrin fushën e mbrojtjes për “çdo të drejtë të parashikuar nga ligji” dhe vendos një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit, që nënkupton situata kur çështja bie në fushën e veprimit të një të drejte substanciale të garantuar nga ligji i brendshëm, pra e drejta për të mos u diskriminuar përkitazi me një të drejtë të rregulluar me ligj, në rastin konkret: të së drejtës për qasje të papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuar.
36. Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar bazën ligjore e ka te Ligji nr. 2004/15 për Ndërtim, i cili në vitin 2012 është shfuqizuar me Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim.
37. Ligji nr.04/L-110 për Ndërtim, ligj që është në fuqi, në kuadër të dispozitave kalimtare, shprehimisht nuk përcakton shfuqizimin e Udhëzimit Administrativ nr.33/2007, kurse në parim, me shfuqizimin e ndonjë ligji, shfuqizohen edhe aktet nënligjore, që nxirren për zbatimin e tij.
38. Sidoqoftë, edhe pse mbajtja në fuqi e akteve nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e ligjit përkatës, pas shfuqizimit të vetë ligjit, nuk është në pajtim me parimet e sundimit të ligjit, vërehet se ky udhëzim ka mbetur në fuqi. Po ashtu vërehet se udhëzimi është shfuqizuar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 02/50, datë 23.12.2021, ndërsa përsëri është kthyer në fuqi me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 05/56, datë 26.1.2022.
39. Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.04/L-110 për Ndërtim, kontestuese mbetet ligjshmëria e udhëzimit dhe se autoritetet përkatëse duhet ta nxjerrin udhëzimin e ri, në pajtim me Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim.
40. Me gjithë problematikën për sa i përket ligjshmërisë së udhëzimit, ky udhëzim ka qenë në fuqi që nga viti 2007. Udhëzimi nuk ka qenë në fuqi vetëm brenda periudhës 23 dhjetor 2021 deri më 26 janar 2022.
41. Në bazë të informatave që komunat i kanë dërguar rezulton se në 21 komuna mesatarja e përqindjes të kriterëve të plotësuar që dalin nga udhëzimi nga të gjitha komunat bashkë është 41%.

42. Kjo përqindje është nxjerrë nga informata që komunat i kanë dërguar. Por për të parë nëse kjo përqindje me të vërtetë paraqet vlerësim real të përmbushjes së kritereve që dalin nga udhëzimi, ka nevojë për një monitorim faktik me ekspertë të fushave të caktuara, gjë që mund të rezultojë në uljen e përqindjes së plotësimit të kritereve të udhëzimit.
43. Ndërsa, 17 komuna nuk i janë përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit për ofrimin e informatave nëpërmes plotësimit të pyetësorit, me çfarë i është pamundësuar Avokatit të Popullit të kryej hetimet përkitazi me këtë raport. Mos përgjigja ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 132, paragrafi 2 si dhe shkelje të Ligjit për Avokatin e Popullit, neni 25. Mos reagimi ndaj një çështje kaq të rëndësishme përbën jo vetëm shkelje të kushtetutës dhe ligjit por edhe mungesë respekti ndaj qytetarëve me aftësi të kufizuara.
44. Komunitet të cilat nuk iu kanë përgjigjur kërkesës së Avokatit të Popullit janë si në vijim:
1. Kamenicë
 2. Lipjan
 3. Leposaviq
 4. Gjakovë
 5. Gjilan
 6. Malishevë
 7. Podujevë
 8. Prizren
 9. Shtime
 10. Skenderaj
 11. Suharekë
 12. Vushtrri
 13. Mitrovicë e Veriut
 14. Partesh
 15. Shtërpçë
 16. Zubin Potok
 17. Zveçan
45. Komunitet të cilat nuk kanë dërguar përgjigje nuk janë përfshirë në kalkulimin e mesatares së përqindjes së plotësimit të kritereve, gjë që len të kuptohet se plotësimi i këtyre kritereve është dukshëm më i ulët se 41%.

Detyrimi për t'u përgjigjur në kërkesat e Avokatit të Popullit nga autoritetet publike, bashkëpunimi si dhe pasojat e refuzimit

46. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, përcakton se çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesë atij të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.
47. Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 25, përcakton detyrimin e bashkëpunimit të autoriteteve publike me Avokatin e Popullit, si dhe pasojat e refuzimit, rrjedhimisht se "të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij". Duke marrë parasysh faktin se nga 38 komuna të Republikës së Kosovës,

që u ishte dërguar pyetëtori nga Avokati i Popullit, përkitazi për rastin në fjalë, dhe vetëm 21 komuna kishin kthyer përgjigje dhe 17 komuna të tjera nuk kishin kthyer asnjë përgjigje, Avokati i Popullit konstaton se këto komuna kanë refuzuar të bashkëpunonin me IAP-në, në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 25, i cili përcakton: “*Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.*” Kurse paragrafi 3 përcakton: “*Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë [...], Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.*”

Praktika e gjykatave të rregullta vendore lidhur me sigurimin e qasjes së papenguar, të lëvizjes, të qëndrimit dhe të punës së personave me aftësi të kufizuara

48. Z. Faruk Kukaj, person me aftësi të kufizuara, i cili ka shumë vështirësi për të lëvizur nga një vend në tjetrin, përfshirë edhe rrugën në Prishtinë, ku ai jeton, e deri në vendin e tij të punës. Z. Kukaj ka pohuar se vështirësi për lëvizje ka edhe për t'i marrë shërbimet shëndetësore në objektet shëndetësore, për t'i kryer shërbimet dhe detyrimet ndaj shërbimeve komunale (pagesa për energjinë elektrike, mbeturinat, ujin etj.), për aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me nxjerrjen në komunë të dokumentacioneve të nevojshme personale, për të dalë me miq apo me të afërm të tjerë të familjes.
49. Më 12 dhjetor 2018, z. Kukaj ka parashtruar padi (C.nr.3663/18) në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, kundër Komunës së Prishtinës, me pretendimet për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuara, gjegjësisht për mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike në hapësirat publike në komunën e Prishtinës për personat me aftësi të kufizuara.
50. Më 18 tetor 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin C.nr.3663/18, ka vendosur ta aprovonte pjesërisht si të bazuar padinë e z. Kukajt, me ç' rast ka detyruar Komunën e Prishtinës që z. Kukajt, për shkak të diskriminimit nga mosveprimi - mungesa e ofrimit të kushteve fizike në hapësirat publike dhe qasjes në objektet publike për personat me aftësi të kufizuara, t'ia kompensonte dëmin e shkaktuar jomaterial, në emër të cenimit të dinjitetit, në shumën prej 5 500 eurosh. Ky është rasti i parë gjyqësor në Kosovë që është bërë në bazë të pretendimeve për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara, përkitazi me qasje dhe lëvizje të lirë në infrastrukturën publike.
51. Më 3 dhjetor 2018, z. Besim Galica ka parashtruar padi (C.nr.534/18) në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri (GjThM-DV) lidhur me pretendime për diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuara. Z. Galica ka pohuar se si person me aftësi të kufizuara dhe shfrytëzues i karrocës si mjet për lëvizje, për shkak të mungesës së kushteve teknike në objektin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, Dega në Vushtrri, ndihej i diskriminuar në raport me persona të tjerë.
52. Më 15 mars 2023, GjThM-DV-ja, me Aktgjykimin C.nr.534/18, ka vendosur ta aprovonte pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë duke vërtetuar se Posta e Kosovës sh.a. e ka diskriminuar paditësin me anë të mosveprimit, duke ia shkelur të drejtën për qasje fizike të përshtatshme në objektin e Postës së Kosovës, filiali në Vushtrri, gjegjësisht duke mos ia mundësuar qasjen fizike të përshtatshme dhe të pavarur në këtë objekt, për marrjen e shërbimeve postare, të cilat do të duhej të ishin në dispozicion për tërë

publikun, dhe në emër të dëmit jomaterial - dhembjeve shpirtërore të përjetuara nga diskriminimi, ka obliguar Postën e Kosovës ta kompensonte në shumën prej 4 500 eurosh. Për më tepër, sipas Aktgjykimit C.nr.534/18 të GjThM-DV-së, Posta e Kosovës është detyruar që menjëherë ta fillonte ndërmarrjen e të gjitha veprimeve për eliminimin e diskriminimit në mënyrë që t'ia krijonte paditësit mundësinë e qasjes fizike vetjake në objektin e Postës së Kosovës sh.a., filiali në Komunën e Vushtrrisë.

53. Avokati i Popullit konsideron se është përgjegjësi e komunave të Republikës së Kosovës t'u kushtojnë vëmendje akteve ligjore që kanë të bëjnë me çështjet e ndërtimit, duke u përkujdesur që objektet të jenë në pajtim me standardet e ndërtimit, duke u përkujdesur që t'i mirëmbajnë vendet dhe hapësirat e tjera publike, me qëllimin të krijimit të mundësive të barabarta për lëvizje të të gjithë personave. Komunitat kanë kompetencë ekskluzive dhe të plotë të ndërmarrin veprime me qëllim të mënjanimit të të gjitha pengesave që pamundësojnë qasjen në objekte dhe në hapësira publike për personat me aftësi të kufizuar, duke bërë paraprakisht një identifikim dhe studim të detajuar të hapësirave të tilla publike. Këto kërkesa janë të përcaktuara edhe në Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim, në të cilin është e përcaktuar korniza ligjore, e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Bazuar në ato që u paraqitën më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla [...]”*; si dhe: *“Të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.”* (neni 18, paragrafi 1.7),

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës:

- Në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësiave institucionale, të nxjerrë udhëzimin administrativ të ri për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në komunitat e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim.

Komunës së Deçanit:

- T'i zbatojë nenet 8, 11, 13, 14, 19, 20, 22, 24, 25, 26, 27, 29, 31, 32, 33, 38, 40, 41, 42 dhe 50 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunitat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Ranillugut:

- T'i zbatojë nenet 13, 14, 20, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 32, 35, 37, 40, 43, 48, 49, 51 dhe 56 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve

Ndërtimore përq Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuarra në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Novobërdës:

- *T'i zbatojë nenet 8, 10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 48, 49, 50, 51, 55, 56 dhe 57 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 përq Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore përq Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuarra në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Kaçanikut:

- *T'i zbatojë nenet 12, 13,14, 18, 19, 23, 24, 25, 26, 31, 32, 33, 35, 37, 38, 40, 42, 43, 44, 48 dhe 49 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 përq Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore përq Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuarra në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Klinës:

- *T'i zbatojë nenet 8, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 32, 33, 35, 37, 40, 42, 43, 44, 49 dhe 56 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 përq Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore përq Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuarra në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Fushë Kosovës:

- *T'i zbatojë nenet 8, 10, 13, 14, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 37, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 49, 55, 56 dhe 57 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 përq Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore përq Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuarra në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Obiliqit:

- *T'i zbatojë nenet 8, 10, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 37, 39, 40, 42, 43, 48 dhe 49 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 përq Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore përq Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuarra në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Ferizajt:

- *T'i zbatojë nenet 11, 12, 13, 14, 17, 19, 20, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 30, 32, 33, 35, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 49 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 përq Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore përq Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuarra në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Istogut:

- *T'i zbatojë nenet 8, 13, 14, 16, 17, 20, 28, 31, 33, 34, 35, 37, 39, 40, 41, 42 dhe 43 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 përq Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore përq Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuarra në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Pejës:

- *T'i zbatojë nenet 8, 10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 48, 49, 50 dhe 57 të*

Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Hanit të Elezit:

- *T'i zbatohet nenet 8, 10, 13, 14, 22, 23, 26, 32, 33, 40 dhe 48 të Udhëzimit Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Mamushës:

- *T'i zbatohet nenet 10, 12, 23, 30, 31, 32, 39, 43, 44 dhe 48 të Udhëzimit Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Vitisë:

- *T'i zbatohet nenet 8, 13, 14, 16, 19, 27, 32, 33, 35, 40, 49 dhe 57 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Dragashit:

- *T'i zbatohet nenet 8, 10, 12, 13, 14, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26, 28, 29, 30, 33, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 49 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Rahovecit:

- *T'i zbatohet nenet 13, 14, 18, 19, 20, 22, 24, 25, 26, 32, 39, 45, 49 dhe 51 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Junikut:

- *T'i zbatohet nenet 8, 13, 14, 24, 25, 27, 30, 32, 33, 35, 37, 41, 42, 43, 44, 49, 56 dhe 57 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Klllokotit:

- *T'i zbatohet nenet 8, 12, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 24, 25, 26, 27, 28, 31, 32, 33, 34, 35, 37, 40, 41, 42, 43, 44, 48 dhe 50 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Mitrovicës së Jugut:

- *T'i zbatohet nenet 8, 10, 11, 12, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 31, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 48, 49, 50, 51, 56 dhe 57 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Graçanicës:

- T'i zbatohet nenet 8, 10, 11, 12, 13, 14, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 28, 30, 31, 32, 33, 35, 38, 39, 41, 43, 48, 49 dhe 51 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Drenasit:

- T'i zbatohet nenet 8, 20, 24, 25, 26, 30, 31, 32, 33 dhe 35 të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Kamenicës:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatohet Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Lipjanit:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatohet Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Leposaviqit:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatohet Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Gjakovës:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatohet Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Gjilanit:

- *Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;*
- *Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Malishevës:

- *Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;*
- *Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Podujevës:

- *Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;*
- *Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Prizrenit:

- *Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;*
- *Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Shtimes:

- *Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;*
- *Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.*

Komunës së Skenderajit:

- *Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;*

- Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Suharekës:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Vushtrrisë:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Mitrovicës së Veriut:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Parteshit:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Shtërpcës:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Zubin Potokut:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Komunës së Zveçanit:

- Të përgjigjet në kërkesat e Avokatit të Popullit në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Të zbatojë Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunat e Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

